

Brixhilda Ndini

Gruaja misterioze

Tregime




8SH-32

N 33

Brixhilda Ndini

Gruaja misterioze

trëgime



*sa mistere ka
aq mbom rje*

Botimet TOENA

Tiranë, 1996

GRUAJA MISTERIOZE

Telefoni ulërin pas dy orë pritjeje të ankthshme të gruas, e cila qe vonuar si kurrë herët e tjera nga pazari që qe duke bërë në merkatën aty pranë. Një zë i huaj tha ftohtë, se ime shoqe ishte rëndë në spitalin nr. 1, në Central Avenue, pas një aksidenti. I tmerruar ul telefonin, kur befas në derë shfaqet gruaja, e zbehtë, me një cifël gjaku të vogël si nishan mbi ballin e argjendtë. Nuk fliste fare, vetëm unë s'pushoja, duke thënë se sa merak isha bërë dhe sa vite më ishin dukur ato pak sekonda në telefon. Kur shkova në banjë, vura re se isha plakur pa masë, kurse ime shoqe, ishte, për hir të zotit, po ajo. Kur i nervozuar klitha dikur, po ti pse nuk më thua diçka, e dashur; bafas ra telefoni dhe zëri i huaj, po me atë ton të zyrtë, kumtoi se më kërkonte falje. Nga ta dinim, zotëri, se në qytet ndodheshin dy njerëz të ndryshëm me të njëjtin emër dhe të njëjtën fytyrë? Ky ishte një gabim i madh. Dhe bashkëbisedimi misterioz u ndërpre.

- Unë quhem Xhoana - thirri befas gruaja ime me një zë alienësh të tmerrshëm. Pse ke ardhur këtu? - klitha duke kërkuar me sy ndonjë send të mprehtë mbi tavolinë. "Sepse gruaja jote është duke vdekur. Unë mund të të mashtroja gjithë jetën, por m'u duk një rrënojë e bukur, e padrejtë, që i kalon kufijtë e mëshirës. I lënduar nga sinqeriteti i saj e mora për krahu dhe shkuam të bëjmë tek Morgonët vizitën e parashikuar.

BISHA QE NUK EKZISTON

Atë vit sapo e kisha mbaruar fakultetin e mjekësisë dhe ende nuk kisha filluar punë. Kërkesës sime për emërim në profilin përkatës nuk i ishte përgjigjur njeri, kur një miku im më sugjeroi të filloja mjeke në morg. Kjo vërtet ishte punë e lehtë dhe mua asnjëherë nuk më kishte shkuar ndërmend, se mund të punoja aty. Ky ishte një lloj misteri, që gjithsesi e kalova për një periudhë kohe shumë të shkurtër, pasi jeta atje filloi të përpëlitej në ritmin monoton. Në fillim të gjithë pacientët ishin të paafroreshëm, me fytyra të tensionuara. E ndieja se si mjeke e re kisha ende nevojë edhe për disa të dhëna mbi spitalin dhe pacientët. Çdo ditë e më shumë vazhdoja të shqetësohesha edhe nga ftohtësia me kolegët. Nganjëherë ngathtësia e tyre më jepte një farë revolte, duke e ditur që pacienti ishte në orët e fundit, e linin në shtrat deri sa ai të jepte shpirt në ato dhomëzat e mbyllura hermetikisht me dritare të errëta. Unë isha ende e re në atë sektor dhe në vetvete kisha një ndjenjë mëshire për të gjithë ata fatkeqë, që më

shihnin të trembur nga një lloj tmerri enigmatik. Çdo gjë më shfaqej e verbër dhe hapat që dëgjoheshin në koridor më dukeshin sikur shkonin drejt një humnere...

Atë ditë isha e shqetësuar për një pacient, të cilit ethet sa vinin e shtoheshin më shumë. Pasi i bëra vizitën më tepër për ta ngushëlluar, duke i dhënë edhe mjekimin e duhur, prita si në faj që gjendja e tij të përmirësohej. Ishte shumë e vështirë të përshtatesha me gjendjen e tij të dëshpëruar. Hyja e dilja nëpër dhomë dhe shihja se si forma e sëmundjes së tij po përhapej më thellë. Atëhere e shqetësuar pranova të rri me pacientin 16 orë në ditë, pa shmangur dot baticën e hijeve që më lagshtonte thellë në eshtra. Përsëri shenjat klinike të sëmundjes mbetën po ato, si gropëza të njëtrajtshme në lëkurën e hënës. Një çast u përqëndrova e tëra dhe fillova të bindja veten, se nuk qenka e lehtë të qëndrosh disa çaste si një urë mbi hidhërimin e tjetrit, duke e lënë thjesht të kalojë. Dëshira për çdo lloj përmirësimi ishte një ankth për mua. Nganjëherë më dukej se nuk do të dilja më prej atij morgu. Pas asaj nate të lodhshme isha shtrirë me gjithë rrobat e punës dhe zgjohem e trembur prej një ëndrre, ku dëgjoheshin vetëm të qeshura. Mungesa e qetësisë filloi të zbehej dhe në fund të koridorit dëgjoheshin të qeshurat e infermiereve që filluan të zmadhoheshin me jehona. Nxitova tek dhoma e pacientit dhe shtanga. Më në fund, i lodhur nga vuajtjet e një sëmundjeje të mërzitshme, kishte vdekur. U ktheva menjëherë tek dhoma e mjekëve dhe urdhërova t'i bëhej autopsia. "Sigurisht" - u

përgjigj doktor Gjergji - "të gjithë pacientët që vdesin në këtë morg i nënshtrohen një autopsie". Ktheva kokën nga ana tjetër dhe pashë dritaret e errëta, duke u pushtuar nga tmërri i keqardhjes. Doktor Gjergji më thërret dhe më shpjegon, se pas autopsisë ka dalë që pacienti vuante nga zemra. Ndjeva një zhgënjim shumë të madh. Më trishtoi buzëqeshja e tij. E dija se pacienti nuk kishte vuajtur nga kjo diagnozë. Nuk është e vërtetë - iu përgjigja doktor Gjergjit. Pacienti asnjëherë nuk më është ankuar nga zemra, bile nuk më ka shfaqur ndonjë dhimbje. Elektrograma që i bëra para disa ditësh rezultoi se zemra funksiononte me një ritëm normal. Rezultati i autopsisë del i qartë. - ma ktheu doktor Gjergji dhe u largua mes dy gjysmave të koridorit, ku në largësi dallohej vetëm një hije vijëzimi.

* * *

Pas atyre ditëve tepër shqetësuese për mua, të shoqëruara edhe me 4 një shpërfillje në bisedat me mjekët vendosa të hyja në kadavrat e morgut duke kaluar atë gjysmëkoridor të errët, që ishte nga ana tjetër e pavionit. E shtyva me tërë forcën e trupit atë derë të rëndë dhe pashë një mori trupash të ruajtur në formalinë. Dikujt ia kishin mbuluar trupin me mushama të zezë, dikujt jo. Mbretëronte një rrëmujë dhe nuk e dija çrregull duhej vënë për të shmangur sadopak shqetësimet. Ajri ishte i ftohtë dhe ndjeva mornica të më përhapeshin në të gjithë trupin.

Afrohem ngadalë dhe mes asaj morie kufomash kërkoj të gjej kadavrën e pacientit tim, që nuk po e shihja askund. Në kadavrat që ndodheshin në fund të sallës, të mbuluara me mushama të zeza, pashë diçka që lëvizi. Nuk doja të frikësohesha, sepse mendova, gjithkujt po të ishte vetë në një morg, me sallë të ftohtë, do t'i dukej sikur shfaqej ndonjë figurë që shquhej përtej dritës në ato muret e çuditshëm, që vetëm vështronin pa lëvizur aspak këmbët e gjata sterile që i mbanin të shtrira nëpër autoklavë. Mure të tmerrshme, - mendova, pesha e tyre tashmë rëndon edhe mbi kadavrën e pacientit tim. Lëviza edhe disa hapa dhe zbulova njërën prej kadavrave, të mbuluar me mushama. Pashë se i mungonin gjymtyrët. Klitha aq shumë, sa me një zë të shumëvujtur fillova t'i flas vetes. - Mos ki frikë, do të qetësohesh sikur s'ka ndodhur gjë. S'më kishte shkuar ndërmend se njeriu mund të vdesë edhe brenda kadavrës së tij në një kohë shumë të shkurtër. - O zot, çfarë tmërri. E kush mund t'ia mbushte mendjen njeriut që edhe pse i vdekur në shtrat mund të rivdiste përsëri ndër vite pa fituar ndonjë lavdi. Era, lagështira, smogu, dhanë përnjëherë konvulsionet e para dhe unë fillova t'i fshihja gjymtyrët nën trup. Përsëri filloi të lëvizte diçka prej fundit të morgut figura e së cilës sa vinte e bëhej më e qartë. Ishte njëra prej kadavrave me një pamje të errët, gati të zyrtë, që m'u përfrua me një bishë të vërtetë. Atë çast kur u ndodhëm ballë për ballë ajo kujtoi se unë po vdisja. Më vjen me të vërtetë keq - foli bisha, që gjymtyrët e tua i mbake të fshehura, dhe si me arsyetimin e një njeriu të

madh, shtoi, - Unë ushqehem vetëm me gjymtyrët e të vdekurve të mi. Kur bëra ta pyesja frymëmarrja më ishte rënduar dhe zëri më ishte ngjirur. Po vazhdoja ta shikoja për herë të dytë, pa mundur të bëja një aluzion mbi trupin e pacientit tim. Atëherë e pyeta: - Mos ke ngrënë edhe gjymtyrët e kadavrës më të fundit që erdhi para dy ditësh? Ajo!? - m'u përgjigj e qetë bisha. Dhe bëri një shenjë me dorë. Eshtë atje. U nisa e tronditur, me një dyshim të çuditshëm në drejtimin e errët të përcaktuar prej bishës. E zbulova kadavrën prej asaj mushamaje të zezë si të dyllosur dhe vërejta se vërtetë pacienti im i kishte gjymtyrët. Ah, mendova, pas atij operacioni gjymtyrët false nuk mund të zhdukeshin. Ato janë gjymtyrët e përkëdheljeve. Si duket, do ta ketë dashur shumë gruan - tha bisha, derisa gjymtyrët ende i ka të paprishura. Tani unë fillova të besoj se vërtet ai mund të kishte vuajtur nga zemra.

ABAZHURI TERMIK

Që kur e kishin blerë, abazhuri i tyre nuk ishte ndezur asnjëherë. Të acaruar ata mendonin se mos tregtari ua kishte hedhur, mbasi ai ishte një abazhur modern me fotoelement. Tregtari me sy të akullt nuk donte të jepte shpjegime, sepse kishte frikë mos i fyente. I lodhur nga ankimi i tyre ai e hapi kapakun e të fshehtës së tij, duke e përshkruar abazhurin si një ikonë të përkryer në tempullin që ata donin të ngrinin. Habitem me ju, si nuk e keni lexuar fletëpalosjen që shoqëron mallin. Kaq e vështirë qenka për t'u përdorur? - pyeti vajza me ironi. "Në qoftë se ju doni të ndriçoni thjesht guaskën e intimitetit tuaj, shkoni dhe blini qirinj të zakonshëm. Ky është abazhuri i dashurisë! - i mëshoi zërit tregtari duke ia rrëmbyer nga dora - dhe, fotocelulat nuk funksionojnë, në qoftë se temperatura në dhomën tuaj nuk arrin limitin e një afshi të nxehtë".